

**FEDERATA E KARATESË E KOSOVËS**  
**KOSOVA KARATE FEDERATION**



**RREGULLORE PËR PUNËN E KOMISIONIT**  
**MBIKËQYRËS TË FEDERATËS SE KARATESË**  
**SE KOSOVËS**

Prishtine, 2021

*Rregullore për punën e Komisionit Mbikëqyrës të FKK-së*

## **I. Dispozitat e përgjithshme**

### **Neni 1.**

Komisioni Mbikeqyres i FKK-se është organ i zgjedhur nga Kuvendi i FKK-se dhe kryen punën e vetë në përputhje me Statutin e FKK-së

### **Neni 2.**

Komisioni Mbikëqyres i FKK-së numëron 5 anëtarë të cilët i zgjedh Kuvendi i FKK-se me madat katervjeqar siq e parasheh Statuti i FKK-se.

### **Neni 3.**

Mandati i anëtarëve të Komisioni Mbikeqyres është 4 vjet, me mundësi të rizgjedhjes.

### **Neni 4.**

Anëtarët e Komisionit Mbikeqyres duhet ti permbahen Rregullores per konflikt interesi te FKK-se dhe si te tille nuk mund te mbajn asnje pozit tjetër brenda FKK-se si: (kryesues komisionesh, anetar Bordi, anetar i ndonje komisioni, përgjedor apo trajner i kombëtarës).

### **Neni 6.**

Anetaret e Komisionit mbikëqyrës e zgjedhin vetë kryesuesin e Komisionei në mbledhjen e tyre të parë kur konstituohet komisioni mbikëqyrës i FKK-së

### **Neni 7.**

Mbledhjet e Komisionit udhëhiqen nga kryesuesi i komisionit dhe asistohet nga Sekretari/ja i/e Përgjithshem i FKK-së i cili në komision ka pozitën e këshilldhënesit pa të drejtë vote.

## **Udhëheqja e Këshillit Mbikëqyrës të FKK-së**

### **Neni 8.**

Mbledhjet e këshillit mbikëqyrës i therret dhe e udheheq kryesuesi i këshillit Mbikëqyrës dhe në bashkëpunim me Sekretarin e FKK-së dhe administratën e FKK-së rregullon dhe kërkon nga ta dokumentacionin percjelles në fushat e caktuara për të cilat janë fushë e interesit të komisionit mbikëqyrës.

### **Neni 9.**

Fushat e mbikëqyrjes janë të gjithanshme dhe varesishtë ku komisioni kërkon informacion Sekretaria e FKK –së duhet të ju ofrojë deshmi dhe informata të cilat ky këshillë i kërkon.

### **Neni 10.**

Anëtarët e Komisionit mbikëqyrës për punën e tyre i përgjigjen Kuvendit të anëtarëve të FKK-së.

### **Neni 11.**

Kryesuesi i Këshillit apo ndonjë anëtarë i këshillit mbikëqyrës mund të lexojë një raport për mbikëqyrje të Punës së FKK-së para Kuvendarëve nëse Komisioni mbikëqyrës e sheh si nevojë për informimin e delegateve të Kuvendit.

### **Neni 12.**

Vendimet e Komisionit Mbikëqyrës të FKK-së merren me shumicë votash, në rast barazimi vendimin përfundimtar e merrë Kryesuesi i Këshillit të FKK-së.

### **Neni 13.**

Secili anëtarë i këshillit mund të abstenojë prej votimit për marrjen e vendimeve ose për çfarëdo çështje tjetër për të cilën ai ose ajo ka interes personal ose ekonomik.

## **Dispozitat përfundimtare**

### **Neni 14.**

Aprovimin e kësaj Rregullore e bënë Kuvendi i anëtarëve cili gjithashtu ka të drejtën ta bëjë ndryshimin dhe plotësimin e sajë me aneks të veçantë.

### **Neni 15.**

Kjo Rregullore hynë në fuqi menjëherë pas miratimit nga Bordi Ekzekutiv i FKK-së dhe miratimit nga Kuvendi i Federates së Karatesë si dhe nënshkruar nga Kryetari i Federatës së Karatesë së Kosovës.

Prishtinë, 19 Qershor 2021

Ismet Krasniqi

Kryetar